



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

29-05-2018

01-785



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Komuna e Malishevës

Datë: 24.05.2018

Numri i takimit të KKSBS-së për vitin' 2018: I-rë

Takim i regullt: PO

Numri i anëtarëve të KKSBS-së të pranishëm: 15

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë: JO

Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë nuk kanë marrë pjesë në këtë takim nga arsyeja se, komunitetet jo shumicë nuk i janë përgjigjur me kohë ftesës me propozimet për përfaqësuesit e tyre konform Udhëzimit Administrativ.

Kryetari i Komunës, në konsulltim me Zyrën Komunale për Komunitete është në fazën e propozimit të anëtarëve të komuniteteve jo shumicë për KKSBS.

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBS-së: PO

➤ Në cilësinë monitoruese, në këtë takim kanë qenë prezent:

- Përfaqësuesi i OSBE-së nga Regjioni Prizren,
- Përfaqësuesi i KFOR-it-LMT zyra në Malishevë, dhe
- Zyrtari për Informim nga Zyra Komunale për Informim, Malishevë

Takimi është kryesuar nga: **z.Hajdin BERISHA**, Nënkryetar i Komunës.

Materiali për takimin e I-rë të KKSBB-së është përcjell me kohë dhe sipas Udhëzimit Administrativ.

Takimi ka filluar në ora: 09:45.

Rendi i ditës:

1. Vlerësimi i Situates së Sigurisë së përgjithshme Publike në Komunën e Malishevës ,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së KKSBB-së,
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës: **m i r a t o h e t** unanimishtë.

Pika e parë :

1. Vlerësimi i Situates së Sigurisë së përgjithshme Publike në Komunën e Malishevës

- z. **Halil MORINA**, Komandant i SP në Malishevë, njoftoj për situatën e përgjithshme të sigurisë publike në komunën e Malishevës, duke potencuar, se sipas statistikave vërehet rramja e kryerjes së veprave penale, si dhe bashkëpunimi më i mirë me të gjitha institucionet relevante lokale, e në veçanti me DKAË dhe atë të Inspektoriatit dhe Bashkësinë Islame në Malishevë.

z. **MORINA**, gjithashtu njoftoj edhe për Planet Operative lidhur me parandalimin e vjedhjeve, mbajtjes së ligjeratave nëpër shkolla dhe mundësisë që të jenë sa më afër komunitetit.

- z. **Xhevat KRYEZIU**, Kryetar i Bashkësisë Islame në Malishevë, vlerësoj situatën të qetë dhe stabile, dhe se rrymat e radikalizmit ekstrem nuk kanë mundur të gjejnë vend në komunën e Malishevës, falë bashkëpunimit dhe punës së Institucioneve.

z. **KRYEZIU**, mëtej tha se, sa i përket pajtimit të gjaqeve, situataq është e qetë.

- z. **Sejdi PAÇARIZI**, kryesues i EVSB-së, njoftoj për aktivitetet e EVSB-së, e në veçanti theksoj projektin me UNDP, lidhur me rrjetëzimin e sigurisë në Evropën JugLindore.

-znj. **Hidajete MAZREKU**, kryesuese e Komitetit Komunal për Komunitete, vlerësoj se në komunën e Malishevës, komunitetet kanë siguri të plotë.

znj. **Hidajete MAZREKU**, mëtej ngriti shqetësimin lidhur me rastet e shtuara të vjedhjeve.

- **z.Gani GASHI**, përfaqësues i OJQ-ve, ngriti qështjen e sigurisë dhe kërkoj siguri më të madhe nëpër shkolla, e në veçanti në shkollat në fshatin Kijevë.

-**z.Januz MAZREKU**, nga Zyra Komunale për Komunitete, njoftoj për aktivitetet e ZKK, si dhe për një rast të një mosmarrveshje familjare të izoluar mbrenda komunitetit Rom.

-**z. Feim Hoxha**, Kryetar i KKPA, gjithashtu shprehu shqetësimin lidhur me sigurin e nxënësve nëpër shkollat e komunës së Malishevës, duke potencuar mungesën e kamerave, lokalet afër shkollave që shërbejnë pije alkoolike etj, dhe mënyra e organizimit të ekskurzioneve.

-**z.Valon GASHI**, Drejtor i DMSH-së, sektori i emergjencave, njoftoj për situatën aktuale të emergjencave lokale si dhe projektet e realizuara, duke shtuar se gjatë këtijë viti nuk pasur Situata të shpalluara Emergjente dhe se nuk ka pasuar as viktima në njerëz, po që si pasojë e vërshimeve ka pasuar dëme jo të konsiderueshme në bujqësi.

z. GASHI, mëtej njoftoj për projektin e MBPZHR, lidhur me spërkatjen selektive të zonave endemike, i cili është në implementim e sipër.

-**znj. Liridona AVDIJAJ - FONIQI**, Përfaqësuese e KLSP-së në Kijevë, njoftoj për themelimin e KLSP-së në Kijevë dhe aktivitetet e tijë, duke potencuar bashkëpunimin e mirë me Stacionin Policor në Malishevë, si dhe për projektin e realizuar vitin e kaluar, duke potencuar mungesën e përkrahjes së qeveris lokale shkakut i zgjedhjeve lokale.

-**z. Hajdin BERISHA, N.kryetar i Komunës**, kryesues i takimit, vlerësoj se Qeveria lokale aktuale është e para, e cila është në dispozicion për 24 orë në ditë për adresimin e qështjeve të sigurisë, njëherit kërkoj që nga kjo pikë të nxirret një rekomandim-konkluzion.

Pika e dytë :

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së KKS-së për vitin 2018,

-**z. Halit MZREKU, koordinator i KKS-së**, prezantoi PVP (planin vjetor të punës për vitin 2018, duke potencuar se, ky Plan Vjetor i Punës paraqet prioritetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2018 dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve të përcaktuara për vitin 2018. Po ashtu, i njëjti përcakton edhe treguesit e matshëm si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr. 02/132 të datës 04.05.2018 është themeluar KKS, përmes së cilave edhe janë përcaktuar: përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë dhe funksionimi i KKS-së.

Gjithashtu, ky Plan i punës për vitin 2018 është mbështetur në Planin e Veprimit të Strategjisë për Siguri në Bashkësi dhe Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi 2011 – 2016 të DSB – MPB.

Ky plan, pra do të shërbejë si bazë për funksionimin dhe organizimin e aktiviteteve të KKSBS-së për vitin 2018, dhe kerkoi që ky plan të miratohet nga KKSBS-ja në mënyrë që të procedohet për në Kuvendin e Komunës.

Kap. Xahvit KELMENDI, përfaqësues i FSK-së, kerkoi që në këtë plan vjetor të punës të përfshihen edhe aktivitetet “ Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, dhe Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shperthyera.

Znj. Feride HOXHA-ISMA, përfaqësuese e PAK, përgëzoj për punën në hartimin e këtijë plani të punës duke kërkuar që këtijë plani ti shtohet edhe aktiviteti “Qasja për PAK” me projektin “Shenjzimi i vendparkingjeve për PAK”.

z. Hajdin BERISHA, N.kryetar i Komunës, kryesues i takimit, me propozimet e paraqitura, e hodhi në votim PVP së KKSBS-së për vitin 2018.

Plani Vjetor i Punës së KKSBS-së për vitin 2018, **m i r a t o h e t** unanimisht nga anëtarët e KKSBS-së.

Pika e tretë :

3. Të ndryshme.

- **z.Gani GASHI,** përfaqësues i OJQ-ve, parashtroj kerkesen për prezencën më të shtuar nëpër shkolla të organeve kompetente.

Znj. Feride HOXHA-ISMA, përfaqësuese e PAK, parashtroj kerkesen për informaten rreth organizimit të ekskurzioneve të shkollave.

Konkluzion:

- “Përkundër rasteve të izoluara të ndodhurak Komuna e Malishevës mbetet mjedis i qetë dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët dhe musafirët e sajë, pa asnjë dallim.”

Rekomandim:


- “Miratohet nga Plani Vjetor i Punës nga anëtarët eKKSBS-së dhe procedohet për në Kuvendin e Komunës.”

Takimi përfundoi në ora: 10:55

Procesverbali u përpilua nga Koordinator i KKSB-së:


Halit Mazreku

Procesverbali aprovohet nga Kryetari i Komunës:


Ragip Begaj



Data e Aprovimit: **29.05.2018**